



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë - Albania, Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. **319** Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M

Nr. 35, datë 01.04.2016

“Për kryerjen e verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, Vendimin nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015.

Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil.

Për këtë arsye

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit nr.23, datë 12.03.2015, Vendimit nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015, në institucionin, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, Vendimit nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015, në këtë institucion, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të verifikimit, me këtë përbërje:
 - Ilirjan Osmanlliu specialist në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
 - Joni Marko specialist në Drejtorinë në Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Procesi i verifikimit të zbatimit të këtij vendimi do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt në datën 06.04.2016 dhe do të vijojë deri në datën 08.04.2016.
4. Me përfundimin e verifikimit në subjekt, grupi i punës do të vijojë me përgatitjen e relacionit, i cili, pas konsultimit me Drejtorin e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, do t'i paraqitet për miratim Komisionerit dhe më tej do të hartohet vendimi për përmbylljen e këtij procesi.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrative (*verifikimit*), do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur; Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë që të marrë masat për realizimin e procesit të verifikimit duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet verifikimit në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedures Administrative dhe akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 319/1 Prot.

Tiranë, 01.04.2016

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i vendimit nr. 23, datë 12.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”; nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Periudha e verifikimit:** Verifikimi do të përfshijë zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Vendimin nr. 23, datë 12.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nga ana e Njesisë Përgjegjëse të institucionit të mbikëqyrur.

- 5. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të fillojë në institucion në datën 06.04.2016 dhe do të përfundojë brenda dates 08.04.2016.
- 6. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet proces-verbal administrativ, i cili nënshkruhet dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 7. Grupi i punës:**
- 1.Ilirjan Osmanlliu Specialist, jurist**
- 2.Joni Marko Specialist, jurist**

8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në procesverbalin e mbajtur në subjektin e verifikuar dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do t'i dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

1.Si janë zbatuar nga ana e Njesisë Përgjegjëse të institucionit të mbikëqyruar në raport me ligjin, rekomandimet e dhëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr.23 , datë 12.03.2015, "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*", nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015, të renditura më poshtë:

- Vendimi nr.23, dt.12.03.2015 dhe konkluzionet e raportit përfundimtar;
- Vendimi nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015;
- Verifikimi i dosjeve të cilat kishin parregullsi në momentin e mbikëqyrjes, fakt, i cili është evidentuar në vendimin e Komisionerit dhe është rekomanduar rregullimi i ligjshmërisë.

2.Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Vendimin nr. 23, datë 12.03.2015 "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*", Vendimin nr.83, dt.31.07.2015 dhe nr.90, dt.10.09.2015.

- 9. Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Dosjet e personelit dhe rregjistri i personelit.
4. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE
DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI

DREJTOR